

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, zhvilloi aktivitetin me temë: "Profesioni i IT-së në epokën e Inteligjencës Artificiale".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte forcimi i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, me synim zhvillimin e kërkimit, mendimit kritik dhe aftësive profesionale në një botë gjithnjë e më të ndikuar nga teknologjia.

Gjatë aktivitetit u trajtuan ndryshimet që po ndodhin në rolin e profesionistëve të IT-së, sfidat që po shfaqen në tregun e punës, si dhe mundësitë e reja që po krijohen në epokën e transformimit digjital.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të njësisë bazë, staf akademik dhe studentë të degës së IT-së, të cilët kontribuan me diskutime dhe ide mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë.

Aktiviteti u relizuan nga studentët e degës së IT-së, nën mentorimin e Prof. Inva Bilo.

